



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, **19.06.2019**

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 18.06.2019 të parashtruar nga "**Grup i Operatorëve Ekonomik NOTI CONSTRUCTION SH.P.K; N.N.T. Bini, Obilic** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Hapja e rrugëve te reja ne zonat rurale**, me Nr. të Prok: **616-19-1817-5-2-1 dhe numër te brendshëm 616 19 053 521** nxjerr:

### V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e **Grup i Operatorëve Ekonomik NOTI CONSTRUCTION SH.P.K; N.N.T. Bini, Obilic** të dt. 18.06.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit **Hapja e rrugëve te reja ne zonat rurale**, me Nr. të Prok: **616-19-1817-5-2-1 dhe numër te brendshëm 616 19 053 521**, kundër *Njoftimit për tenderuesin e eliminuar*, të datës **14.06.2019**.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit per tenderin* **Hapja e rrugëve te reja ne zonat rurale**, me Nr. të Prok: **616-19-1817-5-2-1 dhe numër te brendshëm 616 19 053 521**, sipas rregullave të LPP dhe rregullave dhe Udhëzuesit për Prokurim Publik.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

**Grup i Operatorëve Ekonomik NOTI CONSTRUCTION SH.P.K; N.N.T. Bini, Obilic** me datë 18.06.2019, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Hapja e rrugëve te reja ne zonat rurale**, me Nr. të Prok: **616-19-1817-5-2-1 dhe numër te brendshëm 616 19 053 521**. Autoriteti Kontraktues, me datë **19.06.2019**, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Autoriteti Kontraktues ju njofton se me datën 14.06.2019 ju ka derguar letren standarde për eliminim ku është dhen qarte arsyeja e eliminimit nga ky aktivitet i Prokurimit.

Deklarata juaj se ju keni derguar sqarimet e kerkuara nga ana e Autoritetit Kontraktues me daten 11.06.2019 dite e marte jo me shume se dy dite nga dita e kerkeses per sqarime nuk qendon per arsyes se:

**Autoriteti Kontraktues me datën 07.06.2018 departamenti i Prokurimit ju ka dorëzuar letrën standarde të kërkesës për informata mbi tenderët jo normalisht të ulet, për të cilën ju si OE jeni përgjegjës pas afatit të paraparë në letrën standarde për tender jo normalisht të ulet. Ju përgjigjet e juaja i keni dhënë me datën 11/06/2019, përgjigje këto që kanë kaluar afatin e parapare të caktuar në letrën standarde prej dy ditëve.**

**Në rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik në Nenin 43 - Njoftimi i Tenderuesve / kandidateve pika 43.9 shkruan:**

**Data e njoftimit të tenderuesve / kandidateve është dita 0 e ditëve të obligueshme “në pritje”.**

**Nëse njoftimi dërgohet në ditën e premtë, afati kohor për parashtrimin e ankesës fillon ditën e premtë sepse:**

- **Dita e premtë është dite pune**
- **Në përputhje me Nenin 4 paragrafi 4.2 të Rregullave për parashtrim të ankesave, data e njoftimit është “dita 0”**

**Do të thotë**

- **Nëse AK arrin që të njoftoj zyrtarisht OE ditën e premtë afati kohor për parashtrimin e ankesës fillon ditën e premtë, ndërsa**
- **Nëse AK nuk arrin që të njoftoj zyrtarisht OE ditën e premtë afati kohor për parashtrimin të ankesës fillon ditën e mëtejshme.**

AK – komisioni i vleresimit, ka bërë vleresimin e ofertave gjithnjë duke u mbështetur në LPP dhe në Rregullat e Udhëzuesit Operativ për prokurim Publik.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit